

## TV / interneti / telefoni

Për internet, telefon dhe televizor kabllovik ka ofertues të ndryshëm. Ofertat janë pjesërisht prej vendbanimi të mvarura. Gati të gjithë banoret dhe banorët duhet të paguajnë taksa për radio dhe televizor.

### Taksat për radio- dhe televizor

Në thelb, të gjitha familjet në Zvicër duhet të paguajnë tarifa radio dhe televizioni të pavarura nga pajisja. Me këto taksa të bëra me ligj mbështeten programet e radiove dhe televizionet publike (SRG SSR) si edhe radiot dhe televizionet private. Për marrjen e taksave është firma Serafe përgjegjëse. Tarifa paguhet çdo vit. Personat që marrin shërbime shtesë nga shteti, mund të lirohen nga taksa.

### Telefoni, interneti, televizori-kabllovik

Për telefon, internet dhe televizor kabllovik ka në Zvicër ofertues të ndryshëm. Disa janë në rajone të ndryshëm aktiv. Mvaret nga vendbanimi dhe pjesërisht edhe nga shtëpia se cilat ofera mund të shfrytëzohen. Krahasimi e vlen se shërbimet dhe çmimet janë të ndryshme. Kush don me pas një lidhje përmes satelitit duhet më parë qirradhënesin apo fqinjët dhe fqinjët t`i njoftoj. Lidhjet me internet te shtëpia zakonisht janë shumë të shpejta. Internetkafe ka shumë pak, pasi zakonisht të gjitha shtëpit janë të lidhura me internet.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/banimi/tv--interneti--telefoni](http://www.hallo-baselland.ch/sq/banimi/tv--interneti--telefoni)